

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti juridik
Titulli i lëndës:	E drejta jo-për-përfitim
Niveli:	LLM
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Gjyljeta Mushkolaj
Detajet kontaktuese:	kab. Nr. 18, kati 5
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda “E drejta jo-për-përfitim” studion mjedisin aktual ligjor të sektorit të organizatave jo-për-përfitim në Kosovë, duke marrë në konsideratë rolin e këtij sektori në demokraci, ekonomi të hapur të tregut dhe prosperitetin shoqëror. Për të kuptuar më mirë legjislacionin që ndikon në sektorin e organizatave jo-për-përfitim në Kosovë, ne do t’i analizojmë zhvillimet e reja juridike që ndikojnë në organizatat-jo-për-përfitim në Kosovë, duke i krahasuar ato me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën më të mirë Evropiane. Vendi i veçantë i studimit do të jetë jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Materialet për lexim, diskutimet dhe legjislacioni që do të analizojmë, do t’i ndihmojnë studentët që të mendojnë në mënyrë kritike për dispozitat juridike që i afektojnë organizatat-jo-për-përfitim në Kosovë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe të studiojnë vlerat e mbrojtjes së lirisë së asociimit dhe të pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin social, politik dhe ekonomik, si dhe që Universiteti i Prishtinës të krijojë kuadro për reformë legjislative në harmoni me obligimet kushtetuese.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë sfidat bashkëkohore dhe trendet në teorinë dhe praktikën e lirisë së asociimit, dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare që e garantojnë lirinë e asociimit në sistemin juridik të Republikës së Kosovës; Studentët do të jenë përgjithësisht të vetëdijësuar për ndikimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut në

	<p>rregullimin ligjor të së drejtës në liri të asociimit dhe ndikimin e saj në themelimin dhe veprimin e organizatave jo-për-përfitim në Kosovë.</p> <p>Studentët do të dinë si të hulumtojnë vendimet e rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut të ndërlidhura me lirinë e asociimit dhe të ndërtojnë dhe mbrojnë argumentet efektive duke përdorur precedentin e Gjykatës</p> <p>Studentët do të përmirësojnë të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve duke zbatuar parimet kryesore të legjislacionit që e rregullon lirinë e asociimit dhe organizatat jo-për-përfitim.</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14 javë	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14 javë	14
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5	-	5
Ushtrime në teren	1	1 javë	1
Kollokfiume,seminar e	4	1 javë	4
Detyra të shtëpisë	5	1 javë	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14 javë	28
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1 javë	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1 javë	3
Projektet,prezentimet ,etj	1	1 javë	1
Totali			91

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Sesionet e lëndës përbëhen nga ligjëratat, diskutimet në klasë dhe një prezantim gojor pesë minutësh nga secili student gjatë semestrit. Studentët priten të kenë lexuar materialet e caktuara para orëve të klasës, për të arritur në kohë dhe të jenë të përgatitur për të marrë pjesë plotësisht në diskutimet në klasë. Studentët kërkohet të marrin</p>
-------------------------------------	---

	<p>pjesë në të gjitha klasat, sepse kollokiumi dhe provimi përfundimtar do të përfshijë pyetje në lidhje me materialet e mbuluara vetëm në orët e ligjëratave dhe të ushtrimeve, si dhe materiale nga lexime të caktuara si detyrë. Pjesëmarrja në ligjërata është e detyrueshme dhe do të mbahet evidencë e prezencës së studentëve.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet si vijon:</p> <p>10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime</p> <p>10% - Prezantimi gojor</p> <p>10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë)</p> <p>30% - Kollokiumi</p> <p>40% - Provimi final</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>OSI/ICNL, Guidelines for Laws Affecting Civic Organizations, New York, 2004 https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/guidelines_laws_english.pdf</p> <p>Vendimet e GjEDNj të obligueshme për konsultim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rasti: United Communist Party of Turkey and Others v. Turkey Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, 30 Janar 1998 http://www.icnl.org/knowledge/pubs/CommunistPartyTurkey.pdf • Rasti: Socialist Party and Others v. Turkey Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, 25 Maj 1998 http://www.icnl.org/knowledge/pubs/SocialistParty.pdf • Rasti: Sidiropoulos & Others v. Greece Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, 10 Korrik 1998 http://www.icnl.org/knowledge/pubs/Sidiropoulos.pdf <p>Ligji nr. 04/l-57 për Lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2764</p> <p>Lexuesi i përgatitur për kursin</p>
Literatura shtesë:	<p>Nussbaum, M.C., 2012. <i>Not for profit: Why democracy needs the humanities</i>. Princeton University Press.</p> <p>Young, D.R., 2013. <i>If not for profit, for what?</i>. (1983 Print Edition) Lexington Books.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Mbrotjtja Ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut." <i>Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>. Prishtinë: Ministria e Drejtësisë dhe UNDP, 2009.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Mbrotjtja evropiane e lirive dhe të drejtave të njeriut." <i>Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>. Prishtinë: Ministria e</p>

	<p>Drejtësisë dhe UNDP, 2009.</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Local Government and the Right to Freedom of Association." <i>Kosovo Decentralization Dialogue</i>, LGI/OSI Budapest, and KFOS Prishtina, 2006, Prishtinë</p> <p>Mushkolaj, Gjyljeta. "Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e Lirive dhe të drejtave të njeriut", <i>Manual për përgaditjen e provimit të jurisprudencës</i>, Prishtinë, OSCE dhe Kosovar Institute for Euro-Atlantic Integration, 2004, Prishtinë.</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Marrëdhënia e legjislacionit vendor për rregullimin e sektorit jo-për-përfitim me të drejtën ndërkombëtare</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Mbrojtja e të drejtës në Liri të Asociimit 2. Dispozita të zgjedhura të instrumenteve ndërkombëtare dhe evropiane për të drejta të njeriut që mbrojnë lirinë e asociimit
Java e dytë:	<p>Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut si obligim kushtetues për interpretim të të drejtës për liri të asociimit në Kosovë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. United Communist Party v. Turkey 2. Sidiropoulos and Others v. Greece 3. Freedom and Democracy Party (ÖZDEP) v. Turkey
Java e tretë:	<p>Liria e asociimit dhe organizatat joqeveritare/organizatat jo-për-përfitim</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjedisi Ligjor për zhvillimin e organizatave jo-për-përfitim në Kosovë 2. Mjedisi Ligjor për zhvillimin e organizatave jo-për-përfitim në Shqipëri <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A janë individët e lirë që t'iu bashkohen, apo jo organizatave-jo- përpërfitim sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë? • Ku qëndron baza juridike? • Për sa i përket organizatave jo-për përfitim, cilat janë burimet e së drejtës, sipas hierarkisë së tyre?
Java e katërt:	<p>Kuadri Ligjor për Organizata jo-për-përfitim</p> <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A është kuadri ligjor për Organizata jo-për-përfitim në Kosovë dhe në Shqipëri në harmoni me standardet evropiane?
Java e pestë:	Themelimi dhe Regjistrimi i organizatave jo-për-përfitim

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fitimi i cilësisë së personit juridik 2. Organi shtetëror përgjegjës për regjistrim 3. Regjistri publik <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si e fiton një organizatë jo-për-përfitim statusin e personit juridik në Kosovë? • A është regjistrimi i organizatave joqeveritare i obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë?
Java e gjashtë:	<p>Struktura dhe udhëheqja e organizatave jo-për-përfitim</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dispozitat e obligueshme për aktet e brendshme udhëheqëse 2. Dispozitat opcionale për aktet e brendshme udhëheqëse 3. Përgjegjësia juridike e themeluesve , udhëheqësve, anëtarëve të bordeve dhe e të punësuarve 4. Detyrimet e lojalitetit, nikoqirllëkut dhe të konfidencialitetit 5. Ndalimi i konfliktit të interesit <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cfare duhet të përmbajë Statuti i një OJP-je? • A duhet domosdo të përfillen dispozitat e Statutit nga vet OJP-ja? • Si zbulohet konflikti i interesit?
Java e shtatë:	<p>Statusi jo-për-përfitim i organizatave joqeveritare</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndalimi i dobisë private direkte dhe indirekte 2. Parimi i mos-shpërndarjes së fitimit 3. Ndalimi i keqpërdorimit të kompetencës 4. Ndalimi i shkatërrimit të asetëve <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ku qëndron dallimi midis biznesit dhe një OJP-je? • A janë rrogat dhe kompenzimet për punë shpërndarje e fitimit? • Shembuj të keqpërdorimit të kompetencës?
Java e tetë:	<p>Veprimtaritë e organizatave jo-për-përfitim</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Veprimtaritë në dobi të publikut 2. Veprimtaritë e politikave publike dhe veprimtaritë politike 3. Veprimtaritë ekonomike <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ku qëndron dallimi midis OJP-së që merret me çështje politike dhe partive politike? • A mund të mbështesin OJP-të ndonjë parti politike gjatë fushatës zgjedhore? • Ku qëndron dallimi midis një institucioni arsimor të

	inkorporuar si jo-për-përfitim dhe atij të inkorporuar si biznes?
Java e nëntë:	Kollokuium
Java e dhjetë:	<p>Organizatat me status të përfituesit publik</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullimi i statusit ligjor të organizatave me status të përfituesit publik 2. Regjistrimi dhe kushtet për ruajtjen e statusit të përfituesit publik <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A konsiderohen organizatat joqeveritare tatim-pagues në Kosovë? • A kanë të drejtë OJP-të të kenë lehtësi financiare, tatimore, doganore dhe lehtësi të tjera fiskale?
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Përfitimet tatimore për Organizata jo-për-përfitim</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lirimi nga tatimi në fitim 2. Tatimimi i veprimtarive ekonomike 3. TVSH dhe obligimet doganore 4. Tatimet e tjera <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ku qëndron arsyeja për lehtësi tatimore, fiskale dhe doganore për OJP? • A është kjo konkurrencë jo-lojale për biznesin?
Java e dymbëdhjetë:	<p>Raportimi dhe mbikqyrja</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportimi dhe mbikqyrja e mbrendëshme 2. Raportimi dhe auditimi nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore 3. Raportimi autoriteteve gjegjëse për licencim 4. Raportimi donatorëve 5. Hapja e informacioneve për publikun <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka të drejtë publiku që të dijë për misionin, aktivitetet, performancën dhe financat e organizatave-jo-për-përfitim në Kosovë? • Si shpjegohet kjo çështje sipas llojeve të OJP-ve?
Java e trembëdhjetë:	<p>Raportet tjera të Organizatave jo-për-përfitim me shtetin</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grantet dhe kontratat shtetërore 2. Transferimi i aseteve dhe veprimtarive shtetërore te OJP-të <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pse shteti i financon OJP-të?
Java e katërbëdhjetë:	<p>Organizatat joqeveritare të huaja dhe ndërkombëtare dhe burimet e huaja të fondeve</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi i OJP-ve të huaja dhe ndërkombëtare në Kosovë

	<p>2. Financimi i huaj i OJP-ve në Kosovë</p> <p>Diskutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A duhet toleruar veprimin e OJP-ve të huaja dhe ndërkombëtare në Kosovë? • A duhet lejuar financimin e OJP-ve nga burime të huaja?
Java e pesëmbëdhjetë:	OJP-të dhe rregullat e konfliktit të interesit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.</p>	